



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 282, datë 08.09.2020**

**PËR**  
**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...}**  
**TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË**  
**GJYKATËN E APELIT DURRËS PËR NJË POZICION TË LIRË NË FUSHËN E TË**  
**DREJTËS PENALE DHE GJYKATËN E APELIT TIRANË PËR DY POZICIONE TË**  
**LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR.**  
**174, NR. 184 DHE NR. 185, DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
**DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA**  
**LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit nr. 174, datë 28.05.2020, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale” si dhe, Vendimeve të tij nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj, z. Alban Toro,

**VENDOSI:**

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimin e Këshillit nr. 174, dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 184, nr. 185, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtuëshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimin e Këshillit nr. 174, dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 184, nr. 185, datë 28.05.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**